

## Garanci e Limituar

Shitesi i BlackBerry Solution, që përfshin BlackBerry Handheld (i cili sëbashku me BlackBerry Cradle përbën BlackBerry Hardware), BlackBerry Desktop Software, dhe shërbimin e transmetimit të të dhënave pa kabëll dhe dokumentacionin, Research in Motion Limited ("RIM") që është prodhuesi dhe përfaqësuesit të tij, Research in Motion UK Limited, me Nr. rregjistrimi 4022422, me seli në adresën: Centrum House, 36 Station Road, Egham, Surrey, UK, TW20 9LF, ju garanton JU, përdoruesin ("JU"), që BlackBerry Hardware nuk do të ketë difekte gjatë përdorimit dhe në materiale për një periudhë që përfundon 1 (një) vit nga dita kur BlackBerry Hardware u ble së pari nga Ju si përdoruesi kryesor ("Periudha e Garancisë"). Kjo garanci e limituar nuk është e transferueshme. Gjatë periudhës së Garancisë, BlackBerry Hardware, ose një apo me shumë komponente të BlackBerry Hardware, do të riparohet dhe zëvendësohet sipas zgjedhjes së RIM pa pagesë si për pjesët dhe për punën e kryer. Nëse BlackBerry Hardware (ose komponent prej saj) është riparuar apo zëvendësuar gjatë Periudhës së Garancisë, Periudha e Garancisë do përfundojë jo më vonë se 91 ditë pas riparimit apo zëvendësimit ose një (1) vit nga dita e blerjes fillestare. **Ju lutemi, konsultoni Guidën e Përdoruesit të BlackBerry Handheld për instruksione se si të përfitonit asistencën e klientit për BlackBerry Hardware tuaj.**

Kjo garanci e limituar nuk aplikohet gjatë prishjes dhe carjes normale, ose nëse ndonjë komponent i BlackBerry Hardware është hapur ose riparuar nga dikush jo i autorizuar nga RIM, dhe nuk mbulon riparimin ose zëvendësimin e ndonjë BlackBerry Hardware, të dëmtuar nga: shpërdorimi, lagështia ose lëngjet, afërsia dhe ekspozimi ndaj nxehtësisë, aksidente, abuzime, neglizhencë, keqpërdorim, ose defekteve për shkak të riparimeve ose modifikimeve të bëra jo nga persona të RIM apo përfaqësuesit e shërbimit të autorizuar të tij. Kjo Garanci e Limituar nuk mbulon dëmtimin fizik të sipërfaqes së BlackBerry Hardware duke përfshirë plasaritje apo gervishtje mbi ekranin LCD. Sic është përcaktuar në këtë Garanci të Limituar, përveç BlackBerry Hardware kjo Garanci e Limituar nuk aplikohet për pajisje të tjera ose ndonjë dem të shkaktuar nga pajisje periferike. Garancia e Limituar gjithashtu nuk aplikohet nëse keqfunksionimi vjen si rezultat i përdorimit të BlackBerry Hardware me aksesorë, produkte, shërbime ose pajisje periferike ose të varura jo të aprovuara shprehimisht apo parashikuara nga RIM, dhe ku është përcaktuar nga RIM që ky keqfunksionim nuk është për faj të vetë BlackBerry Hardware. Përveç kësaj, nëse keqfunksionimi vjen si rezultat i gabimit të përdoruesit për mosveprim në përputhje me Rregullat teknike që përfshihen në paketën e BlackBerry Solution, që përbëhet nga BlackBerry Hardware, Programi BlackBerry i Desktop-it dhe shërbimi i transmetimit të të dhënave të lidhura pa kabëll dhe dokumentacioni ("BlackBerry Solution"), Garancia e limituar mund të jetë e pavlefshme dhe nëse është e pavlefshme nuk do mund të aplikohet. Ruajtja e të dhënave prezumohet të jetë përgjegjësi e përdoruesit të BlackBerry Hardware. RIM nuk është përgjegjës për të dhëna, që mund të dëmtohen apo humbasin në çdo moment, duke përfshirë, humbjen dhe dëmtimin e të dhënave pa limit gjatë përdorimit të BlackBerry Hardware ose nëpërmjet përdorimit të programit të sinkronizuar. Për ato shërbime të transmetimit të të dhënave pa kabëll që jepen si pjesë e BlackBerry Solution dhe që janë siguruar nëpërmjet RIM apo rishitësi të RIM nëpërmjet një pale të tretë furnizuese ose operatori të telefonisë celulare, RIM nuk garanton ose siguron që shërbimi i transmetimit të të dhënave pa kabëll do jetë gjithmonë i disponueshëm ose do të funksionoj gjithmonë rregullisht. Ju duhet të kontaktoni operatorin e telefonisë celulare për të përcaktuar çfarë garancish dhe çfarë niveli shërbimi ata ju ofrojnë në lidhje me BlackBerry Solution. Për këtë dhe për arsye të tjera, ju nuk mund të mbështeteni te BlackBerry Solution për transmetimin e të dhënave në raste emergjence apo kërcënime të jetës apo situata kritike misioni, dhe RIM refuzon çdo përgjegjësi në emër të tij dhe të rishitësave të tij për ngjarje apo dëmtime që shkaktohen prej kësaj varësie të tillë apo dëmtimi të shërbimit të transmetimit të të dhënave që duhet të funksionoj apo të jetë i disponueshëm për përdorimin e BlackBerry Solution duke përfshirë, pa limit, mungesën e shërbimit në zonen ku Ju deshironi te BlackBerry Solution.

RIPARIMI OSE ZËVENDËSIMI I BLACKBERRY HARDWARE OSE TE KOMPONENTIT TE DËMTUAR JANE MËNYRAT E VETME TE KOMPESIMIT TE PERCAKTUARA NE LIDHJE ME BLERJEN DHE PERDORIMIN E BLACKBERRY SOLUTION. RIM, NË EMËR TË TIJ, TË DISTRIBUTORËVE DHE RISHITËSAVE TË BLACKBERRY SOLUTION DHE NË EMËR TË CDO KOMPANIE TË KONTROLLUARA NGA OSE NË KONTROLL TË PËRBASHKËT ME RIM OSE NJË PËRFAQËSI TË RIM (KOLEKTIVISHT, "GRUPI RIM I KOMPANIVE" DHE INDIVIDUALISHT "KOMPANIA RIM GRUP") NEPERMJET KESAJ MOHOJNË TË GJITHA GARANCITË, KUSHTET, PERFAQESIMET, VËRTETIMET E TJERA OSE GARANCITE E CDO LLOJI, TË SHPREHURA APO TË NËNKUPTUARA, DUKE PËRFSHIRË POR JO DUKE U KUFIZUAR TE GARANCIA TREGTARE, CILËSIA E SHITJES, CILËSIA E KËNAQSHME, PËRSHTATJA PËR NJË PËRDORIM TË VECANTË OSE QËLLIM, TITULL, MOSSHKELJE, OSE QË MUND TË RRJEDHIN NGA RREGULLA OSE ZAKONE OSE RRJEDHJA E

MARRËVESHJEVE OSE QËLLIMI TREGTAR. TË DREJTAT TUAJA TË DETYRUESHME SI KONSUMATOR NUK DO TE PREKEN PËR SA KOHË QE JU MUND TË KENI TË DREJTA TË TILLA TË DETYRUESHME.

AS RIM DHE AS NDOJË KOMPANI E GRUPIT RIM NUK DO TË JENË NË ASNJË MËNYRË PËRGJEGJËS PËR CDO DËMTIM APO HUMBJE INDIREKTE, TË RASTËSISHME, TË VECANTA OSE QË KANE RRJEDHUR DREJTEPERSEDREJTI (DUKE PËRFSHIRË PA LIMIT, DËMTIME PER FITIME TË HUMBURA, HUMBJE TE TË ARDHURAVE TË BIZNESIT, NDERPRERJE TE BIZNESIT, HUMBJE TE INFORMACIONIT TE BIZNESIT, OSE HUMBJE TE TJERA FITIMESH) QË VIJNË SI REZULTAT I PËRDORIMIT OSE PAFATESISE SE PERDORIMIT TE PROGRAMIT, MADJE EDHE NËSE RIM DHE/OSE NJE KOMPANI E GRUPIT RIM JANË VENE NË DIJENI TË MUNDËSISË SË KËTYRE DËMTIMEVE. KY KUFIZIM KA PËR QËLLIM TË APLIKOHET DHE DO APLIKOHET PA MARR PARASYSH NËSE KËTO DËMTIME JANË KERKUAR, SHPALLUR APO ËSHTË NGRITUR PADI, PADI PËR ZHDËMTIMIN E DËMIT (DUKE PËRFSHIRË EDHE NEGLIZHENCËN) APO TE PËRFSHIRË NË KONTRATE, OSE NËN GARANCI, OSE NËN NDOJË LIGJ TJETËR OSE FORME PADIE, PERVEC PERGJEGJESISE PER VDEKJEN OSE DËMTIMIN PERSONAL,PER TE CILEN NUK ESHTË PERCAKTUAR ASNJE LIMIT, PËRGJEGJËSIA E RIM, KOMPANIVE TË GRUPIT RIM DHE CDO DISTRIBUTORI TË AUTORIZUAR OSE RISHITËSI TË BLACKBERRY SOLUTION NDAJ JUSH PËR HUMBJEN APO DËMTIMIN QË RRJEDH SIPAS KËSAJ MARRËVESHJE NUK DO TË TEJKALOJ NË TOTAL KOSTON E ZËVENDËSIMIT TË HARDWARE TË DËMTUAR BLACKBERRY. Asgjë në këtë marrëveshje nuk do të përjashtoj apo do përpiqet të përjashtoj ose dhe të kufizoj përgjegjësinë për vdekjen apo dëmtimin personal të shkaktuar për neglizhencë të RIM, punëtorëve të tij ose agjentëve.

GARANCIA E LIMITUAR PËR SA I PËRKET PROGRAMIT TE SERVERIT TE BLACKBERRY ENTERPRISE, PROGRAMIT TE DESKTOP-IT, DHE GJITHË DOKUMENTACIONIT OSE CDO PROGRAMI KOMPJUTERIK QË ËSHTË PJESË E BLACKBERRY HARDWARE ËSHTË E PARASHTRUAR MË VETE NË MARRËVESHJEN PËR LICENSËN E PROGRAMIT. GARANCIA E LIMITUAR PËR CDO AKSESOR BLACKBERRY TË POROSITUR MË VETE ËSHTË GJITHASHTU E SHPREHUR NË NJË GARANCI TË LIMITUAR TË VECANTË QË SHOOËRON AKSESORIN PËRKATËS.

Heqja dorë nga RIM për mospërbushje detyrimesh nuk do të konsiderohet një heqje dore në vazhdim nga kjo mospërbushje ose nga cdo mospërbushje tjetër.

Garancia e limituar do zbatohet nga dhe në përputhje me ligjet e Anglisë dhe Uellsit, me përjashtim të rasteve kur ka konflikte ligjesh. Palët në këtë Garanci të Limituar ("Palët" sëbashku dhe një "Palë" në vecanti) ranë dakort që Konventa e Kombeve të Bashkuara mbi Kontratat për shitjet ndërkombëtare të mallrave është e paaplikueshme ne teresine e saj ne këtë Garanci të Limituar. Të gjitha mosmarrëveshjet dhe konfliktet që lindin nga ose ne lidhje me këtë Garanci të Limituar do të zgjidhen nga arbitrazhi. Vendimi i arbitërit do jetë përfundimtar dhe i detyrueshëm për Palët (vetem neqoftese është dukshëm i gabuar). Vendimi i arbitrit do jetë ne forme te shkruar dhe do te kete dispozitiv. Vendimi i arbitrit duhet të përmbajë koston e arbitrimit që do të paguhet nga palët në atë masë që arbitri e mendon te arsyeshme. Vetem neqoftese është e ndaluar nga legjislacioni vendas, arbitrazhi do të: (i) mbahet në Londër, Angli; (ii) nën legjislacionin anglez, (iii) në gjuhën angleze; në bazë të rregullave të Arbitrazhit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë ("Rregulla"); dhe (v) çështja do dëgjohet nga një arbitër i caktuar në përputhje me rregullat e lartpërmendura, i cili do pranohet reciprokisht nga Palët brenda 30 ditëve nga dita e caktimit të arbitrit. Në rast dështimi të marrëveshjes arbitri do të emërohet nga Presidenti i Shoqërisë Britanike të Kompjuterave në momentin e kërkesës për arbitrazh (ose nga një person i ngarkuar me detyrë nga presidenti për të vepruar në emër të tij) në bazë të aplikimit të cdo Pale. Nëse dispozitat e fjalisë së mësipërme janë në kundërshtim me ligjin vendas, arbitrazhi do të: (i) mbahet në Tiranë, Shqipëri; (ii) në gjuhën angleze; (iii) çështja do kaloj në arbitrazh ne përputhje me Rregullat e Arbitrazhit dhe procedurat e Qendrës MEDART ("Rregullat MEDART"); dhe (iv) çështja do dëgjohet nga një arbitër në përputhje me Rregullat e Medart dhe do pranohet reciprokisht nga Palët brenda 30 ditësh nga dita e caktimit të arbitrit, dhe në rast dështimi të marrëveshjes Qendra MEDART do të caktoj arbitrin. Asnjë konflikt midis Palëve, ose që përfshin cdo person vec Ju, nuk mund të bashkohet ose kombinohet së bashku, pa aprovimin paraprak me shkrim të RIM.

Nëse një klauzolë e Garancisë se Limituar është e paligjshme ose jo e detyrueshme, nuk do të thotë që do të shfuqëzohet ose do bëjë të pa detyrueshme të tërë Garancinë e limituar, por për më tepër Garancia e limituar do të interpretohet sikur nuk përmban klauzola të pavlefshme ose te padetyrueshme dhe të drejtat dhe detyrimet të secilës Palë do të interpretohen dhe zbatohen në përputhje me rrethanat.

Nëse do ketë ndonjë mospërputhje midis Garancisë së Limituar dhe cdo garancie tjetër të përfshirë në paketimin e Aksesorit, klauzolat e Garancisë së Limituar do të aplikohen për sa kohë do jetë kjo mospërputhje.

E drejta e autorit – 2006 Research In Motion Limited. Të gjitha të drejtat të rezervuara. Të gjitha markat, imazhet dhe simbolet e lidhura me familjet e Blackberry dhe RIM janë pronë ekskluzive e Research In Motion Limited. Simbolet e RIM, Research In Motion, 'Always On, Always Connected', "envelope in motion" dhe simboli i BlackBerry janë regjistruar ne zyrat e Kombeve te Bashkuara per Patentat dhe Markat mund të jenë në pritje ose të regjistruar në vende të tjera. Të gjithë market e tjera, emrat e produkteve, emrat e kompanive, markat tregtare dhe markat e sherbimit janë pronë e pronarëve përkatës. Pajisje që mbahen në dorë dhe/ose programet shoqëruese janë të mbrojtura nga e drejta e autorit, marrëveshjet ndërkombëtare dhe patenta të ndryshme duke përfshirë një ose disa nga patentat e Kombeve te Bashkuara si vijon: 6,278,442; 6,271,605; 6,219,694; 6,075,470; 6,073,318; D,445,428; D,433,460; D,416,256. Patentat e tjera janë regjistruar ose janë në proces në vende të ndryshme të botës. Ju lutem vizitoni për të parë listen aktuale te patentave të zbatueshme.